

VENDIM
Nr. 538, datë 19.9.2018

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2018, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E TURIZMIT DHE MJEDISIT DHE MINISTRINË E KULTURËS, PËR
PAGESËN E KUOTAVE TË ANËTARËSIMIT NË ORGANIZATAT
NDËRKOMBËTARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 190/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, në buxhetin e miratuar për vitin 2018, në programin “Planifikim, menaxhim dhe administrim”, në kategorinë e shpenzimeve korrente, i shtohet kundërvlehtë në lekë e fondit prej 21 500 (njëzet e një mijë e pesëqind) eurosh, për kryerjen e pagesave të kuotave të anëtarësimit në Zyrën Ndërkombëtare të Ekspozitave (BIE).

2. Ministrisë së Kulturës, në buxhetin e miratuar për vitin 2018, në programin “Planifikim, menaxhim dhe administrim”, në kategorinë e shpenzimeve korrente, i shtohet kundërvlehtë në lekë e fondit prej 48 664 (dyzet e tetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katër) eurosh, për kryerjen e pagesave të kuotave të anëtarësimit në Observatorin Evropian të Medias.

3. Efekti financiar i parashikuar në pikat 1 dhe 2, të këtij vendimi, përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2018.

4. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Kulturës dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama